



R/EPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës  
01nr 112-29247  
Dt: 31.05.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11 13 dhe 58. a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03L-040, e në harmoni me nenin 27.1 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale si dhe Përfundimit 01 nr. 06-27996-12/1 i miratuar në mbledhjen e Bordit me dt. 25.05.2016 për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe përpilimin e regjistrit të përfituesve të subvencioneve në lëmin e shëndetësisë me dt: 31.05.2016 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për shqyrtimin e kërkesave dhe përpilimin e regjistrit të përfituesve të subvencioneve në lëmin e shëndetësisë, në këtë përbërje:

1. Znj. Arbërore Sefa, kryesuese e komisionit
2. Z. Elmir Tarani, anëtar
3. Znj. Shqipe Qarkaxhiu, anëtare
4. Znj. Fehmije Jaka, anëtare
5. Znj. Vjollca Dujaka, anëtare

2. Komisioni i formuar sipas pikës së parë të diapozitivit të këtij vendimi, duhet të angazhohet për shqyrtimin e të gjitha kërkesave të qytetarëve të cilët kanë aplikuar për ndihma në lëmin e shëndetësisë dhe të harton regjistrin e ri me emrat e përfituesve të subvencioneve të DSHMS-së. Regjistri duhet t'i dorëzohet drejtorit të DSHMS-së, me qëllim të kryerjes së veprimeve të ndërlidhura me pagesën e subvencioneve, sipas të dhënave të përfituesve të cilat janë të përshkruara në këtë regjistër.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit



Kryetarja e Komunës  
Znj. Mimoza Kusari- Lila